

CoSolve-19

Instrument këshillimor për zbutjen e pasojave të COVID-19 për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)

UDHËZUES

THIRRJE PËR PROPOZIME
PËR SHËRBIME KËSHILLIMORE DHE TRAJNIME



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



1. Informacion i përgjithshëm

1.1 Sfidat si pasojë e COVID-19

Pandemia e shkaktuar nga COVID-19 e ka goditur rëndë ekonominë shqiptare. Pas karantinës dhe ndalimit të përgjithshëm të lëvizjeve vendosur në 18 mars 2020, masat e para për zbutjen e rregullave të forta u prezantuan në mes të majit.

Për shkak të rimëkëmbjes ekonomike të ngadaltë dhe papunësisë në rritje, bizneset në sektorin e turizmit nuk do të kenë, apo do të kenë shumë pak të ardhura gjatë kulmit të sezonit turistik në korrik dhe gusht. Për më tepër, bizneset e turizmit varen shumë edhe nga turistët ndërkombëtarë që aktualisht janë dhe do të jenë në numër shumë të reduktuar në muajt e ardhshëm. Në këto kushte, sipas ekspertëve, ka të ngjarë që shumë biznese të shkojnë drejt falimentimit, sidomos ato biznese që nuk do të kenë mundësi t'u paguajnë bankave kreditë hipotekare.

Sektori i bujqësisë po ashtu është ndikuar negativisht nga situata aktuale. Bujqësia ka një rëndësi të madhe për zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë, duke qenë se kontribuon me rreth 20% në PBB-në e vendit dhe përfaqëson 42% të punësimit të përgjithshëm. Shumica e pothuaj 350.000 bizneseve bujqësore janë fermerë të vegjël që jetojnë me këtë veprimtari dhe vetëm afërsisht 50.000 shoqëri tregtare janë të orientuara drejt tregut. Strukturat e fermave janë të vogla dhe komplekse, me madhësi mesatare prej 1,2 ha dhe të copëtuara në 3 deri 5 ngastra me madhësi dhe cilësi të ndryshme toke. Aktualisht ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) janë ato që ushtrojnë aktivitetin kryesor në zinxhirin e vlerave për tregun e brendshëm, pra, subjekte fermerë që ua sheshin produktet drejtpërdrejt restoranteve, apo shërbimeve gastronomike si edhe konsumatorëve dhe dyqaneve.

Pavarësisht nga këta dy sektorë, turizmi dhe bujqësia, duhet thënë se shoqëritë tregtare në të gjithë sektorët janë prekur nga ndikimet e krizës, përmendim tregëtinë me pakicë, tekstilet, lëkura, etj. Dhe kjo kryesisht sepse struktura e biznesit në Shqipëri kryesisht përbëhet nga biznesi i vogël.

Gjithsej 95% e 160.000 bizneseve kanë mesatarisht jo më shumë se 10 punonjës dhe si rrjedhojë, janë më të predispozuar të pësojnë dëme të konsiderueshme nga ndalimi i veprimtarive fizike të bizneseve të tyre, sidomos për shkak se shumica e tyre nuk kanë gjetur ende zgjidhje digjitale për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të tyre. Bizneset shqiptare duhet të përshtaten dhe t'i zhvillojnë bizneset e tyre online si në fushën e operacioneve të biznesit me klientët, ashtu edhe të operacioneve biznes me biznes. Përshtatja ndaj instrumenteve digjitale mund t'u ofrojë atyre mundësi të reja shitjeje me afat të shkurtër, por mbi të gjitha, mund t'i bëjë këto shoqëri tregtare të përshtatshme në të ardhmen gjatë gjithë kohës së krizës, por dhe më tutje.

Për shkak të situatës në përgjithësi të vështirë, GIZ-i ka krijuar një Instrument këshillimor që ofron trajnime dhe shërbime këshillimi për NMVM-të, me mundësi edhe për të marrë grante të vogla, me qëllim për tu përshtatur në këtë situatë të re.

1.2 Qëllimi i Instrumentit Këshillimor

Instrumenti këshillimor për zbutjen e krizës së COVID-19 është një iniciativë e përbashkët e programeve dypalëshe të Bashkëpunimit gjermano-shqiptar për Zhvillim, përkatësisht: “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, promovimi i punësimit, arsimit dhe aftësimi profesional” (shkurtimisht: ProSEED) dhe Zhvillimi i qëndrueshëm rural (shkurtimisht: SRD). Qëllimi i përgjithshëm është mbështetja e NMVM-ve të prekura rëndë nga pasojat e krizës së COVID-19 në Shqipëri, pikësepari për të ruajtur punësimin dhe pse jo edhe për ta rritur atë. Në realizimin e kësaj iniciative, ProSEED dhe SRD synojnë të japin një kontribut të rëndësishëm për NMVM-të anë e mbanë Shqipërisë në sektorët e bujqësisë, turizmit, apo sektore të tjera. Gjithashtu, NMVM-të do të forcohen në përdorimin e zgjidhjeve të reja digjitale dhe inovacionit, jo vetëm për të amortizuar krizën aktuale, por edhe për t'i përshtatur aktivitetet e tyre me qëllim adoptimin në situatën e re post Covid. Këto qëllime do të arrihen duke u ofruar NMVM-ve këshillim dhe trajnime të përshtatura sipas nevojave të tyre individuale duke përfshirë informacion mbi mundësitë e financimit të ideve të tyre.

1.3. Mekanizmi i Instrumentit Këshillimor

Shërbimet këshillimore janë qëllimi bazë i këtij instrumenti. Për të përmbushur pritshmëritë e NMVM-ve në lidhje me marrjen e informacionit gjithëpërfshirës dhe këshillimit të përshtatur sipas nevojave, instrumenti do të punojë ngushtësisht me NMVM-të në seancat e ndryshme të trajnimit. Pas një seance orientuese, NMVM-të do të marrin vlerësime profesionale dhe këshilla që të pasqyrojnë situatën e tyre specifike të biznesit, duke marrë në konsideratë të veçantë operacionet e biznesit si: marketingun, riorganizimin, inovacionin & teknologjinë, menaxhimin e cilësisë etj. Qëllimi i seancave këshillimore është të krijojnë ide për ndryshime dhe adoptim në situatën e re, si edhe të japin informacion rreth mundësive të financimit për nevojat e adresuara në kërkesat e bizneseve. Gjithashtu, shërbimet këshillimore duhet të sqarojnë se cilat nevoja financiare janë më të rëndësishme në situatën aktuale dhe t'u japin bizneseve një ide të përgjithshme se ku mund të gjejnë mbështetje financiare nëpërmjet skemave të ndryshme të donatorëve.

Procesi i këshillimit dhe trajnimit në thelb është i strukturuar në tre hapa:

Hapi 1- do të rezultojë në planin individual të ndërhyrjes për cdo biznes.

Hapi 2 – do të zhvillohen trajnime specifike për ndryshimin/përshtatjen e planit individual të biznesit sipas planit të veprimit të hartuar në hapin e parë.

Hapi 3 – ka te beje me vijimin e keshillimit/trainimit ne fazen e zbatimit te planit te ri ne biznesin perkates.

Të tre hapat do te zbatohen brenda një periudhe maksimale prej 4 muajsh në varësi të nevojave, disponueshmërisë dhe vendndodhjes së aplikantit. Secili hap mund të zgjasë deri në një ditë pune të ndarë në disa seanca trainimi. Aplikanteve do tu ofrohen edhe aktivitete/trainime te tjera ne grup, me qellim shkembimin e eksperiencave, apo mundesi bashkepunimi mes tyre.

Të gjitha NMVM-të që kanë marrë pjesë me sukses në seancat e trajnimit dhe ato këshillimore dhe që nuk kanë mundësi të aplikojnë në skema financiare të donatorëve të tjerë, kanë mundësinë të bëjnë kërkesë për grante të vogla nga ky instrument. Gjithsesi, NMVM-të duhet të jenë të ndërgjegjshme se ky instrument nuk mund të mbulojë të gjitha nevojat e tyre financiare.

Procesi i përzgjedhjes për grante do të bëhet nëpërmjet një thirrjeje tjetër në një fazë të mëvonshme. Përfituesit e granteve gjithashtu do të përfitojnë edhe trajnime të tjera shtesë në fazën e zbatimit të projekteve të tyre. Trajnime të tjera do të mund të ofrohen edhe për NMVM-të që nuk kanë kërkuar ndonjë mbështetje financiare, por që kanë nevojë për këshilla të vazhdueshme gjatë gjithë fazës së ndryshimit të tyre për tu adoptuar në situatën e re post Covid.

2. Objektivat e Instrumentit Këshillimor

Përmes këtij instrumenti parashikohet ofrimi i një numri shërbimesh këshillimore dhe trajnimesh për aplikantët që do i përgjigjen kësaj thirrjeje të hapur.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj thirrjeje për shërbime këshillimore dhe trajnime është:

Mbështetja e NMVM-ve në sektorët e bujqësisë, turizmit dhe sektorë të tjerë, për të kaluar me sukses krizën e COVID 19 nëpërmjet këshillimit dhe trajnimeve me qëllim ruajtjen e vendeve të punës, apo edhe rritjen e punësimit.

3. Elementët e Instrumentit Këshillimor

Aplikantët do të përfitojnë nga trajnimet e përshtatura sipas nevojave që do të fokusohen në amortizimin e krizës së COVID-19 si edhe në rikuperimin e bizneseve dhe përshtatjen e tyre ndaj situatës së re post Covid.

Shërbimet trajnuese dhe këshilluese do të kryhen virtualisht (online) dhe/ose fizikisht në varësi të situatës së COVID-19 (duke marre ne konsiderate protokollet e Covid 19) dhe

mundësive nga ana e biznesit, apo dhe nevojave të tyre specifike. Shërbimet këshillimore mund të përfshijnë trajnime, seminare dhe uebinare.

Gjithashtu, të gjitha NMVM-të do të marrin informacion të hollësishëm për mundësitë e sigurimit të financimeve nga skemat e qeverisë, apo nga skemat e donatorëve të tjerë sipas nevojave të bizneseve të vëna në dukje në aplikimet e tyre.

Vendndodhja e biznesit: Në gjithë Shqipërinë

Linjat e sektorëve që mund të marrin pjesë në thirrje janë si më poshtë:

1. Turizmi: Thirrja është e hapur për bizneset e akomodimit të regjistruara mikro, të vogla, të mesme (hotele, agro-turizëm, bujtina, kampingje) operatorë turistikë të regjistruar si edhe restorante në zonat rurale që ofrojnë aktivitete turistike.
2. Bujqësia: Thirrja është e hapur si për fermerë individualë ashtu edhe për persona fizikë dhe juridikë që zotërojnë, apo përfaqësojnë NMVM që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin, grumbullimin, përpunimin, apo marketimin e produkteve bujqësore.
3. Sektore të tjera: Thirrja është e hapur për NMVM-të që janë prodhues të tekstileve dhe veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, bizneseve të artizanatit etj., si dhe biznese të tjera që janë demtuar si pasoje e Covid 19.

Për të tre grupet e lartpërmendur, do të ketë një dritare të veçantë këshillimi për zgjidhje inovative dhe digjitale të funksionimit të bizneseve.

Në këtë thirrje, NMVM-të kërkohet të dorëzojnë aplikime ku përcaktohet një nevojë e qartë biznesi që u ka dalë gjatë, apo si rrjedhojë e pandemisë së COVID-19 në të paktën një prej **fushave të ushtrimit të aktivitetit të biznesit:**

- Zhvillim produkti
- Burime njerëzore
- Marketim dhe/ose mekanizëm shitjesh
- Tregje të reja
- Inovacion dhe teknologji
- Menaxhim cilësie, përfshirë standardet dhe certifikimin
- Menaxhim financiar

4. Rregullat e thirrjes për propozime

4.1 Kualifikimet e NMVM-ve për t'u përzgjedhur për të përfituar shërbime këshillimi

Madhësia: Xhironja maksimale e NMVM-së sipas ligjit shqiptar deri në 14.000.000 Lek në vit.

Pronësia: 100% biznese me pronësi private, në zotërim të shtetasve shqiptare.

Bizneset duhet të jenë të regjistruara si ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme, apo të kenë Nipt aktiv fermeri.

Maturimi: Biznesi duhet të ketë ushtrim zyrtar aktiviteti minimumi 1 vit përpara fillimit të pandemisë COVID-19 (biznesi është regjistruar para 1 Mars 2019).

Sektorët:

- **Turizëm:**
 - NMVM akomodimi (hotele, agroturizëm, bujtina, kampingje);
 - Operatorë turistikë të regjistruar dhe guida turistike;
 - Objekte shërbimi (bare & restorante në zonat rurale që ofrojnë aktivitete turistike).

- **Bujqësi:**
 - Fermerë individualë (me NIPT aktiv fermeri);
 - Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor
 - NMVM-të që ushtrojnë aktivitetin e tyre në prodhimin, grumbullimin, përpunimin; marketimin dhe shitjen e produkteve bujqësore.

- **Sektorë të tjerë:** Thirrja është e hapur për NMVM-të që janë prodhues të tekstileve dhe veshjeve, lëkurës dhe këpucëve, bizneseve të artizanatit etj.,si dhe biznese te tjera që jane demtuar si pasoje e Covid 19.

4.2 Moskualifikimi i aplikantëve për shërbime këshillimi

Bizneset nuk kualifikohen nëse:

- Janë në procedura likuidimi, falimentimi, apo mbylljeje;
- Janë dënuar, apo proceduar për vepra penale, apo aktivitete mashtruese biznesi;
- Janë regjistruar si biznese apo si fermerë individualë pas dates 1 Mars 2019.

4.3 Procedurat e aplikimit

4.3.1 Si të aplikosh për Instrumentin këshillimor

Thirrjet për kërkesa do të publikohen www.cosolve19.al

Të gjitha NMVM-të që plotësojnë kriteret e sipërpërmendura mund të dërgojnë paketën e aplikimit për instrumentin këshillimor.

Aplikimet do të bëhen online nëpërmjet www.cosolve19.al

Propozimet e dërguara me mënyra të tjera (për shembull me faks, kopje fizike, postë elektronike, etj.) do të refuzohen. Propozimet e shkruara me dorë **nuk** do të pranohen. Nëse kërkuessit e interesuar nuk mund të sigurojnë dokumentet e aplikimit, janë të ftuar të dërgojnë një email në cosolve@giz.de.

Aplikimi do të jetë në **gjuhën shqipe**. Paketa e aplikimit përbëhet nga dokumentat e mëposhtme:

- Formulari i aplikimit ku shprehen qartë nevojat e biznesit në përputhje me fushat e lartpërmendura të ushtrimit të aktivitetit të biznesit (shih kapitullin 3);
- Kopje e dokumentit të regjistrimit si subjekt tatimor (NIPT) e NMVM-së dhe numri individual i regjistrimit për fermerët individualë (NIPT fermeri);
- Kopje e deklaratës se tatimit të thjeshtuar të fitimit leshuar nga Drejtoria e Tatimeve;
- Vërtetim ku të thuhet se kërkuessi nuk ka procese penale në ngarkim të tij (në format PDF), leshuar nga Ministria e Drejtësisë;

Do të konsiderohen vetëm aplikantët, të cilët kanë dërguar paketën e plotë të aplikimit me dokumentat e sipërpërmendura. Paketa duhet të dërgohet brenda afatit të caktuar. Dokumentat e dërguara me vonësë nuk do të pranohen.

Gjatë aplikimit të keni parasysh sa më poshtë:

- Pasi të keni dërguar aplikimin tuaj, nuk do të keni mundësi të bëni më ndryshime;
- Sigurohuni që adresa e emailit tuaj dhe numri i telefonit të jenë aktive dhe të disponueshëm për kohëzgjatjen e plotë të procedurës së përzgjedhjes;
- Është e rekomandueshme të mblidhet i gjithë informacioni i nevojshëm përpara se të filloni të plotësoni formularin e kërkesës online;
- Të gjitha fushat kanë kufizime në germa. Numri maksimal i germave të lejuara bëhet i njohur në çdo fushë;

- Ju lutem kujtoni që t'i ruani rregullisht të dhënat tuaja, me qëllim që të shmangni humbjen e të dhënave në rast ndërprerjeje të lidhjes së internetit , ose çështjeve të tjera teknike që mund të ndoshin gjatë aplikimit.

4.3.2 Afati

Për shkak të kërkesës së lartë nga ana e bizneseve për përgatitjen e dokumentave, afati për dorëzimin e aplikimeve shtyhet deri në datë 7 Prill 2021 në orën lokale 23:59.

4.3.3 Informacion shtesë / pyetje

Pyetjet mund të dërgohen me email jo më vonë se 7 ditë përpara përfundimit të afatit të aplikimeve.

Përgjigjet do të jepen brenda 3 ditësh pas dërgimit të pyetjeve.

5. Vlerësimi dhe përzgjedhja e propozimeve

Të gjitha propozimet e dërguara do të vlerësohen sipas rregullit: **kush aplikon i pari shërbehet i pari, për çdo grup/sector** Meqenëse do të ketë kufizime lidhur me shërbimet e këshillimit dhe trajnimit, 70 NMVM-të e para nga çdo grup/sector që kalojnë kontrollin administrativ, verifikimin e dokumentacionit, si edhe vlerësimin e kontrollit të nevojave, do të kenë mundësi të përfitojnë nga skema e instrumentit këshillimor.

HAPI 1: Kontrolli administrativ dhe verifikimi i dokumentacionit

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve nga 1 deri 10, të përshkruara në tabelën e vlerësimit për përfitimin e shërbimeve këshillimore. (*SHIH SHTOJCA 3: Tabela e vlerësimit për përfitimin e shërbime këshillimore*).

Aplikimet e paplota nuk do të pranohen.

Do të kontrollohet gjithashtu përputhshmëria midis kërkesave të përcaktuara në seksionin 4.3.1 dhe dokumenteve të dorëzuara.

Çdo mospërputhje mes kërkesave të thirrjes dhe dokumentave mbështetëse mund të çojë në refuzimin e propozimit.

HAPI 2: Vlerësimi i nevojave të biznesit

Në këtë fazë, aplikimet do të vlerësohen në bazë të kriterëve teknike 11 dhe 12, të përshkruara në tabelën e vlerësimit për mbështetje këshillimore (*SHIH: SHTOJCËN 3: Tabela e vlerësimit për përfitimin e shërbime këshillimore*).

Aplikantët që nuk i kanë deklaruar/ shprehur qartë nevojat e biznesit nuk do të merren në konsideratë.

70 aplikantët e pare nga çdo sektor/grup që kalojnë me sukses:

- Kontrollin administrativ dhe verifikimin e dokumentacionit; dhe
- Vlerësimin e nevojave

do të përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe trajnimit.

SHTOJCAT

- 1. Formulari i aplikimit**
- 2. Listë kontrolli për dokumentat mbështetëse**
- 3. Pyetje për vlerësimin e aplikimit**

1. Listë kontrolli e dokumentave mbështetëse

Listë kontrolli për paketën e plotë të aplikimit	Verifikimi	PO/JO
1. Formulari i aplikimit	Modeli i dhënë	
2. Kopje e skanuar e numrit të regjistrimit si subjekt tatimor (NIPT) e NMVM-ve, apo numri personal i regjistrimit në rastin e fermerëve.	Kopje e skanuar e certifikatës së regjistrimit	
3. Kopje e skanuar e Deklarates te tatimit te thjeshtuar te fitimit.	Kopje e skanuar e deklarates	
4. Kopje e skanuar e certifikates më e fundit që tregon se kërkuesi nuk ka proces penal në ngarkim të tij (në format PDF), e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë.	Kopje e skanuar e dëshmisë së penaltetit e lëshuar në 3 muajt e fundit	

Shënim: Kategoria “Fermer individual i regjistruar (me NIPT Fermeri) përjashtohet nga plotesimi i pikës nr.3

2. Pyetje për vlerësimin e aplikimit

1	A është dorëzuar paketa e aplikimit brenda afatit nëpërmjet faqes së internetit?
2	A është e plotë paketa e aplikimit?
3	A është plotësuar formulari i aplikimit sipas modelit të duhur të dhënë nga GIZ?
4	A është biznesi i regjistruar në Shqipëri dhe është pronë e një shtetasi shqitar/ Në rastin e fermerëve a ka numër regjistrimi si fermer?
5	A është xhiroja maksimale e biznesit 14.000.000 lekë (afërsisht 120.000 EUR), e kategorizuar si NMVM?
6	A ka ushtruar NMVM-ja aktivitetin e saj të biznesit para 1 marsit 2019 (1 vit përpara Covid)
7	A kategorizohet NMVM-ja në një nga sektorët e përfshirë në këtë thirrje?
8	A kategorizohet nevoja e biznesit të paktën në një nga fushat e ushtrimit të aktivitetit të biznesit?
9	A është NMVM-ja në procedura likuidimi, falimentimi apo mbylljeje?
10	A është përfaqësuesi ligjor i NMVM-së i dënuar, apo i proceduar për vepra penale, apo aktivitete mashtruese biznesi?
11	A është aplikimi i qartë dhe i kuptueshëm?
12	A janë nevojat e biznesit në përputhje me objektivat e thirrjes dhe të shprehura qartë?